

REVISTË MUJORE PËR FËMIJË, TË RINJË DHE PRINDËR, - MAJ 2007 -NR 2

DITURIA

E BOTON QKSH "MIGJENI" BORÅS-SUEDI





*Revistë kulturore, letrare, artistike
shoqërore e argëtuese për fëmijë, të
rinjë, prindër e mësues*

Përmbajtja:

DITURIA

*Boton QKSH "Migjeni"
Borås-Suedi*

Kryeredaktor :

Sokol Demaku

Këshilli redaktues:

Rahman Jashari

Lena Liden

Agron Çela

Ramadan Myrtaj

Arsim Daka

Hakif Jashari

Adresa e redaksisë:

Revista Dituria

C/O

Studie främjandet

L. Kyrkogatan 20

503 07 Borås

3. Nga redaksia

4. Letrat falendëruese

*5. Konferenca e mësuesve të gjuhës
amtare shqipe*

6,7. Ismail Kadare

8. Thënie për gjuhën

9,10,11,12. Për më të vegjëlit tanë

13. Poezi për fëmijët

*14. Një e keqe ogurzezë që po godet
pa mëshirë*

15. Dom eller vi?

16. Ata ose ne?

*17. Dhënia e ndihmës së parë shpëton
jetën*

18. Kuzhina shqiptare

19. Për orët e lira

20. Të jesh apo të mos jesh?



Me përpjekje të mëdha u arrit që në muajin prill të dali në dritë numri i parë solemn i revistës shqiptare "Dituria" në qytetin e Boråsit. Që në fillim do të falënderojmë që të gjithë ata që na ndihmuan në realizimin e këtij projekti madhor kombëtar. U jemi mirënjohës individëve që sakrifikuan kohën e tyre të vlefshme dhe na erdhën në ndihmë me ide dhe kritika të vlefshme për suksesin e kësaj reviste.

U jemi mirënjohës enteve dhe institucioneve të qytetit të Boråsit për ndihmën dhe përkrahjen morale dhe materiale që na kanë dhënë në këtë drejtim.

Falënderojmë dhe u jemi mirënjohës edhe bashkëkombasve tanë për ndihmën dhe mbështetjen morale. Shpresojmë që ju do të jeni të kënaqur me punën tonë në vazhdim.

Dëshirojmë që lexuesve tanë të respektojmë t`u kërkohet falje dhe mirëkuptim për gabimet eventuale të mundshme teknike dhe gjuhësore që kanë mundur me na u përvjedhë në numrin e parë të revistës sonë dhe tuaj "Dituria".

Besojmë dhe shpresojmë që në të ardhmen gjëra

të tilla nuk do të na përsëriten dhe seksualiteti i revistës gjithnjë do të vijë e të jetë sa më i mirë. Për realizimin e këtij qëllimi dhe objektivit nësi redaksi u bëjmë thirrje të gjithë artdashësve, adhuruesve të fjalës së shkruar që të na bashkangjiten në këtë projekt. I ftojme të rinjtë dhe të rejtat, fëmijët, prindërit, punëtorët, pensionerët që të na ndihmojnë me idetë dhe kritikën e tyre në begatimin e faqeve të revistës sonë dhe tuaj. Mendojmë dhe besojmë se secili prej nesh mund të kontribuojë në këtë drejtim. Pra jeni të mirëseardhur jo vetëm me shkrimet e juaja por edhe me verejtjet dhe sugjerimet e juaja në mënyrë që të na ndihmoni në përmirësimin dhe begatimin e faqeve të revistës suaj dhe tonë me tema interesante për jetën, punën dhe problemet tona.

Ju informojmë edhe me atë se këto ditë redaksia e revistës ka formuar edhe "Klubin letrar" e ju jeni të mirëseardhur në këtë klub. Me këtë kemi menduar që të krijojmë pena të reja të cilat do jenë të afta që ta qojnë përpara këtë nismë. Punimet e juaja mund të na i dërgoni në adresën postale të redaksisë së revistës si dhe përmes

postes elektronike të përkohshme (email):

dituriash@hotmail.com

Në posaqërisht falënderojmë të gjithë ata që na u lajmëruan përmes telefonit dhe na përgëzuan për punën e bërë, falënderojmë të gjithë ata nga vendi dhe nga vende të ndryshme të botës që na u drejtuan me përsëritje dhe përgëzime përmes letrave dhe postës elektronike.

Ju faleminderit për përgëzimet! Përgëzimet dhe falënderimet e juaja na japin kurajo për vazhdimin e punës sonë dhe tek ju gjejmë mbështetjen për të cilën kemi nevojë.

Ejani të afirmojmë së bashku kulturën dhe traditën tonë shqiptare.

Redaksia e revistës "Dituria".

Në faqen tjetër do të botojmë disa nga letrat përsëritëse që na arritën nga miqë tanë nga vendi e nga bota.



*Tack för igår och för att jag fick vara med! Vilka trevliga vänner du har!
Med vänliga hälsningar*

**Camilla Winter Internationell samordnare
Kommunledningskansliet Borås**

Ju përgëzoj për Revistën e parë që nxorret në dritë një Dituri, ju uroj edhe për shumë të tjera SUKSESE

Përshëndetje!

Agroni Bajrami (SH.K.A. SHOTA, Zvicër)

Përshëndetje! E morra Revistën e Juaj , më pëlqeu ,kishte nga pak për të gjithë ,e sidomos për të rinjte tanë që kanë nevojë të dinë kush ishte Migjeni, Asdreni, Teuta, Skenderbeu etj.

Vetëm ju uroj suksese dhe të gjitha të mirat në jetë se punë me mend jeni duke bërë. Ju përshëndes gjithë STAFIN E REVISTES!

**Në emër të Sh.K.A. TEUTA,
ME RESPEKT GANI FAZLIU, Zvicër**

Përshëndetje nga redaksia e revistës "Mirësia" dhe "Argument"!

Revistën e pashë. Do të këshilloja në disa pika dhe shpresoj se do të vlejné ne bazë të eksperiencës time 8 vjecare ne media (botim revistash). Së pari revista me pasë më shumë tema që kan vlera edukative dhe tema kulturore. Gjithsesi them se lexuesi ka nevojë për dicka që i shkon në zemër. Të jenë tema që janë sa me aktuale dhe edukative ne cdo aspekt .Them këtë ngaqë e pashë qe kishte shumë njohuri për figurat letrare e kombëtare. Po ashtu mundeni që ti bëni dizajn më të bukur duke përdor kolona e jo me një kolone, që të jetë me i lehtë për lexim të lexuesve. Ma bëni hallall, shpresoj se nuk i merrni per keq keshillat. Porse dijeni se cdo punë sado e vogël qoftë ka vlera te mëdha sepse mjafton që dikush te marri iniciativën për punë te hajrit.

Me kaq nga redaksia e revistave "Miresia" dhe "Argumenti" Damaskus, Siri

Lycka till med den albanska tidskriften. Du får gärna sända den till mig alt. maila den om den finns digitalt. Tack för tidningen. Jag skriver ut den och ger till några bekanta här i Vetlanda som kommer från Kosovo.

**Vänligen //Monica Samuelsson
Redaktör Erikshjälpen Vetlanda Sverige**

E pashë revistën tuaj dhe me pëlqej shumë. Urime, besoj se do te keni sukses. Ju atje keni numër mjaftueshem të shqiptarëve dhe kjo garanton sukses. Ju pershendes dhe ju uroj suksese!

Fadil Demaku, Florida - USA



U mbajtë Konferenca e Katërt e mësuesve të gjuhës amtare shqipe

Në Landskronë të Suedisë, në ambientet e Hotel "Öresund", më 15 dhe 16 maj 2007 u mbajtë Konferenca e Katërt e mësuesve të gjuhës amtare shqipe në Suedi. Kjo konferencë, e organizuar nga Enti për zhvillim të arsimit i Suedisë, në bashkëpunim me grupin e punës nga Landskrona që administron faqen e gjuhës amtare shqipe "Temaplats Albanska", pati si temë kryesore prezantimin e faqes dhe njoftimin e mësuesve për mundësitë për bashkëpunim që ofron faqja e gjuhës amtare shqipe "Temaplats Albanska" dhe ligjerata të mbajtura nga ekspertë të gjuhësisë.

Të ftuar ishin Prof. Dr. Bahri Beci nga Parisi dhe z. Nuhi Gashi nga Ministria e Arsimit të Kosovës.

Prof. Dr. Bahri Beci ditën e parë mbajti ligjëratën "Probleme të lëvrimin të shqipes së shkruar në gjysmën e parë të shekullit XX", kurse ditën e dytë ligjëratën "Probleme të mësimin të gjuhës amtare në etapën e sotme". Këto ligjëratë zgjuan një interesim mjaftë të madh tek mësuesit pjesëmarrës në konferencë.

Z. Nuhi Gashi i njoftoi mësuesit për përpjekjet që po bënë Ministria e Arsimit për të ndihmuar mësimin plotësues në Diasporë.

Ai e prezantoi edhe punën që është duke u bërë për përpilimin e një Planplogrami për Shkollat e mësimin plotësues në gjuhën amtare në diasporë, pastaj informoi për përgatitjet që po behën për organizimin e seminarit të tretë për mësuesit e gjuhës amtare në diasporë.

Seminari, tha ai, do të mbahet në muajin korrik në Durrës ose në Pejë.

Z. Gashi bëri edhe promovimin e librit "Shkolla për gjuhën dhe kulturën e atdheut dhe identiteti kombëtar 2", libër ky me materialet e seminarit për mësuesit e gjuhës amtare në diasporë, mbajtur në korrik 2006 në Prizren. Këtë libër z. Gashi ua shpërndau pjesëmarrësve të Konferencës dhe njoftoi se ata që janë të interesuar këtë libër mund ta marrin falas në MASHT –



Prishtinë.

Për të ligjëruar rreth çështjeve të tjera, ishin të ftuar edhe disa ligjërues të tjerë, si psh. Mats Wennerholm, përgjegjës për projektin "Tema Modersmål", Lisa Flinth, ministre komunale për arsim në Komunën e Landskronës dhe Mona Axelsson, Rektore për gjuhët amtare në Landskronë.

Prezentimi i faqes së gjuhës amtare shqipe në Suedi u bë nga Muhamet Muriqi, administrator i kësaj faqeje.


Përveç sqarimeve dhe shpjegimeve teknike të faqes, u dha edhe një pasqyrë e historikut të faqes dhe rëndësisë së saj për punën e mësuesve dhe nxënësve shqiptarë në Suedi.

Faqja, u tha, do të jetë e hapur për të gjithë ata, që kanë dëshirë të kontribuojnë, duke filluar nga njoftimet e shkurtra dhe diskutimet rreth temave të caktuara e deri te botimi i teksteve dhe mjeteve mësimore të përgatitura nga vetë mësuesit shqiptarë në Suedi.

Faqja do të ketë edhe kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Arsimit ku do të publikohen të gjitha risitë nga kjo Ministri që kanë të bëjnë me Mësimin Plotësues në Diasporë.

Ai bëri edhe prezantimin e programit të ri me fotografi dhe zë "Bildteman" i cili do të jetë një ndihmesë e madhe për mësuesit e gjuhës amtare.

Në konferencë morën pjesë mbi 70 mësues të gjuhës amtare shqipe nga 39 komuna të Suedisë dhe nga Norvegjia.



Ismail Kadare

U lind me 28 janar 1936 në Gjirokastrë. Pas mbarimit të shkollës fillore dhe të mesme në qytetin e vendlindjes, kreu studimet universitare për letërsi, në fillim në Tiranë dhe më vonë pranë Institutit "Gorki" në Moskë. Në jetën letrare shqiptare ka hyrë shumë herët, me botime në shtypin letrar të kohës, në moshën e gjimnazit. Veprat e tij janë botuar në më shumë se 36 gjuhë të botës. Është fitues i shumë çmimeve kombëtare e ndërkombëtare si dhe shumë titujve honorifikë. Vepra dhe kontributi i Kadaresë janë vlerësuar me titullin më të lartë shqiptar: "Nderi i Kombit". Është Anëtar Shok i Akademisë Françeze të Shkencave Morale dhe Politike që nga tetori 1996. Në vitin 1996 shpërngulet dhe jeton në Paris. Prej disa vitesh kohën e tij e ndan mes Parisit dhe Tiranës. Para disa kohësh axhension i njohur "Booker prize foundation" e vlerësoi shkrimtarin e shquar shqiptar Ismail Kadare me titullin "Njeriu ndërkombëtar i librit", çka vinte natyrshëm, pos të tjerash, edhe si njëfarloji "shlyerje borxhi" sadopak, të asaj padrejtësie të madhe që i është bërë shkrimtarit të "vendit të shqipeve", pikërisht në dhënien e NOBELIT. Edhe pse është merituar prej vitesh, kurora e këtij çmimi ka shëtitur kokë më kokë, por pa u ndalur dot në atë të Kadaresë tonë.

"Të lexosh Kadarenë është si të shohësh lavjerrësin e historisë të lëkundet lart e poshtë". Është ky një koment që vjen nga e

përditshmja "The Guardian", nga bota aglishtfolëse e cila e inaguroi dhënien e çmimit "Man Booker International Prize" duke ia akorduar atë shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare.

Përderisa në Tiranë, në vendin e tij, prej kohësh është nisur një "sulm frontal" në ndonjë media, kundër shkrimtarit duke u munduar të ndikojnë negativisht në jurinë ndërkombëtare me shkrimet e tyre. Për çudi të madhe si shumë herë më parë ata që duhet të ngrejë zërin për këtë gjë makabre, për padrejtësinë e madhe që i bëhet shkrimtarit tonë më të madh, heshtin.

Shtrohet pyetja: A mund të jetë një shkrimtar disident? Çfarë do të ndodhte sikur Kadare të ngriste zërin kundër partisë së punës atëher? Përgjegjën e dini ju të gjithë. Ismail Kadare është ai që e formoj dhe ngriti kultin e shkrimtarit në pedestalin më të lartë në kohëra të vështira dhe ai po mundohet që një gjysëm shekulli të veprimtarisë së tij letrare ta ngrisë kulturën tonë aty ku e ka vendin. Kohërat kan ndryshuar por edhe neve duhet të na mësoj historia që ti vlerësojmë drejt arritjet tona kombëtare.

Kadare e cilëson marrjen e çmimit si besim dhe shpresë se një ditë do vijë lajmet e bukura nga Ballkani i etheve dhe turbullirave. "E mora këtë çmim si një shenjë besimi për vendin tonë, për popullin tonë, edhe për popujt tanë fqinjë. Në fund të fundit ne jetojmë në një zonë të botës ku marrim bashkërisht atë turpin kur bëjmë gjëra të turpshme, dhe prandaj bashkërisht duhet të luftojmë për të hequr njollat që na ka vënë bota", pohon shkrimtari për "Shekullin".

Kadare ka thënë njëherë: "Unë jam shkrimtar dhe gjithkujt do t`ja falë çdogjë që bën por askujt sdo t`ja falë që të ngris dorën kundër popullit tim as zotit të madh...". Nuk beson se marrja e këtij çmimi po e çon një hap më afër Nobelit dhe paralajmëron daljen në vjeshtë të romanit më të ri. Një roman i vogël për adoleshencën e një shkrimtari, dhe formimin e tij si qenie artistike.

Shtypi britanik, si e përditshmja "The Guardian" e cilëson "një shkrimtar unik".



“Kjo duket si një frazë e thjeshtë por ky është një vlerësim shumë i madh për një shkrimtar. Nuk dua të hiqem modest, ky është një kompliment shumë i madh. Unik quhet një shkrimtar që krijon një vend që mungonte, që s’është. Të gjitha përcaktimet “shkrimtar i madh”, “shkrimtar i shkëlqyer” janë epitete që kanë vlerat e tyre.”- thotë Kadare.

Shtypi suedez i jep recensione (vlerësime kritike) shumë pozitive romanit “Prilli i thyer” të përkthyer nga Dagmar Olsson nga frengjishtja- një e papritur për të pasi që Ismail Kadare shkruan në gjuhën shqipe.

Eva Ström shkruan se pushon një hije e Shekspirit mbi romanin mjeshtëror të Ismail Kadaresë “Prilli i thyer”. Një Magbeth në Shqipëri shkruan ajo dhe nuk i kursen lavdatat për shkrimtarin tonë të madh. Që kjo temë nuk e lë rehat shkrimtarin tonë del në shesh me romanin “Lulet e ftohta të Marsit”, në të cilin autori ka arritur ta përshkruaj shëndrimin e shoqërisë socialiste në atë demokratike përmes djaloshtit princ- gjarpër. Si të bëhet transformimi nga gjarpëri në princ. Kadare këtu për mrekulli dhe me një stil të shkëlqyer e modern shkruan që duke e xhveshur lëkurën gjarpëri shëndrrohet në princ të pashëm.

Kadare është ndër shkrimtarët që zgjon interesim të madh tek studiuesit e letërsisë. Një studiues britanik i letërsisë thotë se Kadare është përfaqësuesi më i spikatur ndër pesë shkrimtarët ballkanik që e kanë krijuar civilizimin ballkanik.

Ismail Kadare është shkrimtari që ka krijuar mitin e ri në gërmadhat e mitit të vjetër dhe me veprat e tij ka shënuar një kthesë në letërsinë shqiptare. Ai në mënyrë shumë të bukur e paraqiti fatin tragjik të popullit shqiptar duke u zgjeruar edhe në fatin e popujve tjerë ballkanik. Kadare në veprat e tij ka arritur të përfshij të gjitha epokat e kulturës shqiptare. Ndikimi i tij në shoqërinë shqiptare ishte dhe është si një lloj busulle orientuese duke mos harruar kontributin e madh në Rambuje si përfaqësues shpirtëror i të gjithë shqiptarëve.

Ismail Kadare ka një veprimtari të frytshme gjatë punës së tij gjysëm shekullore (53 vjeçare).

Veprat e tij janë:

- ✓ **Frymëzime djaloshare** 1954
- ✓ **Shekulli im** 1961
- ✓ **Gjenerali I ushtrisë së vdekur** romani që e bëri të njohur 1963
- ✓ **Përse mendohen këto male-** 1964
- ✓ **Dasma** 1968
- ✓ **Motive në diell** 1968
- ✓ **Kështjella** -roman- 1970
- ✓ **Kronikë në gur** -roman- 1971
- ✓ **Koha** 1976
- ✓ **Dimri i madh** -roman- 1977
- ✓ **Ura me tri harqe** 1978
- ✓ **Prilli i thyer** 1980
- ✓ **Gjakftohësia** -përmbledhje novelash 1980
- ✓ **Koha e shkrimeve** 1986
- ✓ **Koncert në fund të dimrit** 1988
- ✓ **Vepra letrare** 1981-1989
- ✓ **Dosja H** 1990
- ✓ **Piramida** 1992
- ✓ **Shqipëri** 1995
- ✓ **Pallati i ëndërrave** 1996
- ✓ **Dialog me Alain Bosquet** 1996
- ✓ **Spiritus** -roman- 1996
- ✓ **Kushëriri i engjëjve-ese-** 1997
- ✓ **Poezi** 1997
- ✓ **Kombi shqiptar në prag të mijëvjeçarit të tretë-ese-** 1998
- ✓ **Tri këngë zie për Kosovën -triptik** 1998
- ✓ **Ikja e shtërgut** -tregim- 1999
- ✓ **Qorrfermani** -roman- 1999
- ✓ **Vjedhja ne gjumit mbretëror -tregime** 1999
- ✓ **Ra ky mort e u pamë-ditar për Kosovën, artikuj, letra** 2000
- ✓ **Kohë barbare(Nga Shqipëria në Kosovë)** -biseda- 2000
- ✓ **Breznitë e Hankonatëve** 2000
- ✓ **Bisedë përmes hekurash** 2000
- ✓ **Elegji për Kosovën** 2000
- ✓ **Lulet e ftohta të marsit**-roman- 2000
- ✓ **Unaza në kthetra** 2001
- ✓ **Eskili ky humbës i madh**-ribotim 2001
- ✓ **Qyteti pa reklama**-roman- 2001
- ✓ **Pasardhësi** -roman- 2004
- ✓ **Identiteti europian i shqiptarëve** 2006
- ✓ **Hamleti princi i vështirë** 2006



“Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar,
sado që të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk
8qytetërohet vetëm me mësimin e gjuhëve të huaja, por me
mësimin e gjuhës së vet”

Filip Shiroka

“Ai që e zotëron gjuhën e vet vlen më tepër se ai që pushton një
qytet”

Një mendimtar i lashtë

“Shenjat e civilizimit të një populli janë:

- 1.si kujdeset ai për drunjtë e tij,
- 2.si kujdeset ai për fëmijët dhe pleqtë
- 3.si sillet ai me gjuhën e tij.

Por gjuha është më e rëndësishme. Është detyrë e tij që ta
ruaj dhe ta kultivoj atë si vlerë kulturore dhe si tipar identiteti”

Erwin Chargaff

“Gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli dhe për
popullin shqiptar është i vetmi thesar”

E. Çabej

“Viktimat e gjuhës janë më të shumta se ato të shpatës”

S. Frashëri

“Fjala e huaj në gjuhë është si dhia ndër dhen”

N. Frashëri

“Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e
qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e
pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është tregues i nivelit
të kësaj kulture”

E. Çabej



Për më të vegjëlit tanë

Plotëso nëpër katrorë shkronjat që mungojnë.



V I O N I



R R



N I J



R I U



R Q



I B R



I S



K A I



N A



I F A N T I



D R A




I P U R I



Punime nga nxënësit tanë




Teuta Shabani, Fjärdingskolan - Borås



Pranvera Xhemajli, Hässlegården - Borås



Essidora Hasi, Hässlegården - Borås



Nëna

Një fjalë
një emër
Një fjalë
në zemër
Nënë!

Më mëson e udhëzon
shumë më dashuron
Për jetë më aftëson
Dashuri më ofron.

Arbëresha Jashari, Fjärdingskolan



Våren är vaken

Vår, vår vakna,
Snön är inte här
För nu är de vår.
Solen skiner varmt,
Jag nästan svimmar,
Nu är jag så glad
Jag ser varje blad
Humlor och getingar
Sitter på blommorna
För nu är det vår.

Elsa Stenberg, Hässlegården - Borås

Blerina Asllani, Fjärdingskolan



Drenica ime

Drenicë t'i je ëndërr që me kallë
Drenicë je peng që më mban të gjallë
Drenicë gazelë e vrarë në vetullë
Drenicë çerpiku im i djegurë
Drenicë kullë e dashur e Azemit
Drenicë këngë e pamposhtur e Ademit
Drenicë ti je ëndërr që më le pa gjumë
Drenicë kurrë nuk të lam në gjunjë
se të kemi shqiponjë në flamur
Drenicë të duam shumë...

Mergimi

Xhaxhi, xhaxhi pse s'më thua,
se si është jeta në vend të huaj
Të lutem xhaxhi më tregon
për Kosovë sa mendon.

Isha i vogël kur t'i shkove
nuk mbaj mend se a më përqafove
Xhaxhi të lutem më trego
Nipin tënd sa e do

Nga Kosova po ju shkruaj
k'thehuni ju në vendin tuaj
une për ju sa po vuaj
jeni tanët e s'jeni të huaj.

Shkroi: Elfat Salihu, Göteborg

JU RRËFEJ NJË HISTORI TË JETËS SIME

Unë jam një vajzë e vogël dhe deri para pak kohësh jetoja me mamin, babin, vëllaun dhe gjyshën time.

Një ditë, krejt papritur, mami dhe babi u ndanë dhe bashkë me ta u nda përgjysëm dhe zemra ime.

Familja ime u nda në dy pjesë dhe mua më largoi nga vëllai, babi dhe gjyshja ime e dashur. Nuk di pse unë dhe vëllai im patëm këtë fat.

Jeta më duket e vështirë dhe shpirti më qan në heshjte për fatin e keq që më ra. Kënaqem kur shikoj bashkëmoshatarët e mi tek i shoqërojnë për dore mami dhe babi i tyre. Nuk e di, por shpirti më mbushet me një ndjenjë të çuditshme, ku nga krahërori im buron një llavë e fortë nxehtësie dhe sytë më përlohen, kur e mendoj të shkuarën time të lumtur në krahët e prindërve të mi dhe pranë vëllait tim që e dua aq shumë. Lotët fillojnë të më lagin mollëzat e faqeve. Papritur e krahasoj veten me personazhet e përrallave ku këtë vërtetësi të realitetit e ëndërroj me xhirimet e një filmi dhe personazhet jemi ne: unë dhe vëllai im. A thua vallë është e lehtë për mua, kur fundjava më gjen pa një vend të caktuar, ku një pjesë të kohës jam e detyruar ta kaloj pranë mamit tim dhe pjesën tjetër pranë babit dhe vëllait.

Shpresoj që një ditë shumë të afërt kjo ëndërr e keqe të mbarojë sa më parë dhe ky ankth të më lirojë shpirtin dhe ne të kthehemi në qetësin dhe lumturinë e mëparshme.

Do të doja që kjo histori të mos i ndodhë anjë fëmije dhe nuk ia dëshirojë askujt.

Pres një ditë, kur unë ta bëj gjumin e qetë në krevatin tim me kukullën time të dashur, në strehëzen tonë të dashur me mamin, babin, vëllain dhe gjyshën.

Marrë nga libri "Lundroj në mendimet e mia" Hajli Haxhia, kl II

Shkolla "Ismail Qemali"

Shkodër



Kjo poezi është shkruar nga një adoleshente në ditët e fundit të jetës së saj e sëmurë nga kanceri në një spital të New Yorkut. Dëshiron të shohë sa persona do ta lexojnë. Poezia thotë mjaft gjëra. Ju lutem përcillenit atë. Është dërguar nga një mjek. Përpikuni të lexoni dhe kuptoni porosinë e çmuar të kësaj vajze për vlerën e vërtetë të jetës.

VALLËZIMI I LEHTË

I ke vështruar
ndonjëherë fëmijët
kur vallëzojnë të kapur
përdore?

Apo të dëgjosh zhurmën
e shiut kur bie përtokë?

A e ke ndjekur ndonjëherë
fluturimin e çrregullt
të një fluturë?

Apo të vëzhgosh diellin
atëherë kur nata po
zhduket?

Do të bëje mirë ta
ngadalësoje hapin.
Mos vallëzo kaq shpejt.
Koha është e shkurtër.

Muzika nuk do të zgjasë
përgjithmonë
E përshkon çdo ditë
fluturimthi?
Kur pyet "Si je"?
e dëgjon përgjigjen?

Kur dita mbaron
shtrihesh në krevatin tënd
me qindra pyetje të
njëpasnjëshme
që të vijnë ndër mend?

Do të bëje mirë ta
ngadalësoje hapin.
Mos vallëzo kaq shpejt.
Koha është e shkurtër.
Muzika nuk do të zgjasë
përgjithmonë.

I ke thënë ndonjëherë birit
tënd do ta bëjmë nesër?
pa e vënë re nga nxitimi,
keqardhjen e tij?

E ke ndërprerë
ndonjëherë lidhjen,
me një mik të mirë
e cila ka përfunduar
sepse ti kurrë nuk
kishe kohë
për t'i telefonuar
e për t'i thënë
"Tungjatjeta"?

Do të bëje mirë ta
ngadalësoje hapin.
Mos vallëzo kaq shpejt.
Koha është e shkurtër.
Muzika nuk do të zgjasë
përgjithmonë.

Kur vrapon kaq shpejt
për të arritur diku
humbet gjatë rrugës
kënaqësia e të shkuarit
atje.

Kur shqetësohesh dhe
vrapon gjatë gjithë ditës,
është si një dhuratë e pa
hapur kurrë-e flakur tutje.

Jeta nuk është një vrapim
Merre më shtruar
Dëgjoje muzikën
Para se kënga të përfundojë.

Zgjedhi për ju nga anglishtja:
Agron Çela

Eranda Sadiku 4 vj.



Takimi i rastit me vogëlushën e zgjuar Eranda Sadiku më la mbresa të pashlyera dhe vendosa ta ndaj me juve këtë ngjarje interesante të 30 prillit 2007. Eranda ende s' i ka mbushur 4 vite-por dinte shumë vjersha të bukura që i ka mësuar nga prindërit e saj. Ajo ishte duke luajtur me lojërat për fëmijë në qendrën shëndetësore të Sjëbo-së kur befasi filloi të recitoi:

ABETARJA

Babi, babi ami do pare
T` shkoj ta blej një abetare
Lulekuqe, lulebardhë
Jam vogëlushe e klasës së I-
rë.

KUKULLA

Kukulla ime rri në kuti
I ka faqet gurabi
I ka flokët dredha-dredha
I ka këpucët me kurdela.

VITI I RI

Ja na erdhi Viti i Ri
Eni-eni të këndojmë
Rrotull bredhit të vallëzojmë,
Të kapur dorë për dore
Djem e vajza punëtore,
Këngë e valle brohori
Se na erdhi Viti i Ri.

Shkruar nga: Agron Çela



Një e keqe ogurzezë që po godet pa mëshirë

Abuzimi me substanca psikotrope është një problem i madh shoqëror dhe shendetësor në tërë botën, nga se pasojat që dalin nga efektet e drejtëpërdrejta dhe të tërthorta nga kjo shprehi e kobshme njerëzore janë shumëfish të dëmshme për njeriun që bëhet rob, i kësaj të keqje, i marrjes së materieve dehëse, po ashtu edhe për rrethin e gjërë social ku jeton dhe vepron ky ose një grup abuzuesish të drogave.

Duhet të dijmë se droga paraqet një varg materiesh psiko-aktive të cilat nëse merren nga ana e njerëzve, ato kanë aftësi të dëmtojnë dhe ndryshojnë integritetin psiko-fizik të atij që i përdorë.

Organizata Botërore e Shendetësisë ka dhënë një definicion mbi varshmërinë nga droga në të cilin thuhet: "Vartësia nga droga paraqet një gjendje helmimi kronik ose periodik të individit me droga naturale, gjysëm-sintetike e cila karakterizohet me një dëshirë dhe pasion të pafrenueshëm që të merret me cdo kusht, prirje për të rritur dozën si dhe varshmëri fizike dhe psikike me veprim destruktiv mbi personalitetin e narkomanit. Ky problem del më i mprehtë dhe më serioz kur kihet parasysh fakti se kjo epidemi ogurzezë moderne si të themi prek më së shumti rininë, ardhmerinë e cdo shoqërie në rruzullin tokësor duke mos bërë dallim në shtresat sociale të shoqërisë, gjininë apo moshën e tyre. Të gjithë ata që abuzojnë me këto lëndë shkundullisëse përballen me dukurinë e shfaqjes së sindromit abstencial pas ndërprerjes së konsumimit të këtyre materieve por më shpesh me varshmeri totale të individit nga këto materie. Keto materie do i ndajmë në bazë të efektit të crregullimeve mentale si rezultat i përdorimit kompulsiv në: Alkooli,

iopiatet, kanabinodet, sedative dhe hipnotikë, kokaina, kofeina dhe stimulues të sistemit nervor qendror, halucionagjenët, duhani dhe tretësit që avullohen. Por në anën tjetër është më shumë rëndësi të dihen shkaqet dhe faktorët që sjellin deri tek paraqitja dhe përhapja në përmasa kërcënuese të këtij vesi kompleks që dëmton mirëqenien e njerëzimit. Dukuria e narkomanisë sa vjen e bëhet aktuale, ngase për cdo ditë po rritet numri i konsumuesve të rinjë, bile edhe ndër nxënës të shkollave fillore. Është një rrjet shumë i organizuar i prodhimit, përpunimit, distribuimit dhe përdorimit të drogës. E këto janë kanale të thella në këtë veprimtari por mbetet që të punohet në ndërgjegjësimin e rinisë sonë dhe të potencohen rrethanat që qojnë në parandalimin e kesaj shprehie ogurzezë. Janë disa faktorë që shpjen në përhapjen e narkomanisë e këta janë faktorët që përcaktojnë :

- a) personalitetin e narkomanit ku në raste tipike këta janë adoleshentë psiko-labil të cilët janë intolerant ndaj streseve dhe traumave fizike e psikike, endacak me teke të cuditshme, psikopat latentë të papjekur, neurotikë.
- b) kushtet sociale-ekonomike ku rolin dominant e ka funksionimi i shendoshë i mjedisit familjar me të gjitha premisat e harmonizuara morale e materiale. Ambienti ku rinia shkollohet dhe edukohet ndikon pozitivisht por në të shumtën e rasteve negativisht në paraqitjen e kësaj dukurie ogurzezë si dhe raportet e këqija ndërnjerëzore në mjedis të caktuara.
- c) substancat psikoaktive si faktor provokues me cilësinë e tyre toksike dhe farmakologjike përbejnë një

moment inicues e favorizues për të kerkuar shpëtim idilik, e ketë e kërkojnë dhe e gjejnë tek droga. Por edhe përdorimi legal i medikamenteve, hipnotike bile edhe narkotike që arsyetohet nga mjekët me anë recete, indirekt shton kuotën e narkomanëve. Derisa bejmë fjalë për faktorët stimulues të kësaj dukurie me implikime të parenovueshme sociale ekonomike duhet të pranojmë si inkurajues faktin se masat e ndryshme preventive deri në 50% kanë ulur numrin e narkomanëve ndër adoleshentë për një periudhë 10 vjeçe. Pra cilat janë këto masa që duhet ndërmarrë që mundësojnë një efikasitet kundër kësaj sëmundje sociale?

Së pari duhet punuar më shumë me prindër e mësues të cilët rrisin dhe edukojnë brezin e ri, personeli mjekësor me mjekun familjar, psikiatër, psikologët, sociologët dhe pedagogët. Praktika jetësore na mëson se një e keqe nuk shkon vetëm andaj edhe ky lloj "dëfrimi" rrënuet përcillet me sëmundje të ndryshme si hepatiti, (Sida) Aids si dhe me kriminalitet, vjedhje, dhunë, prostitucion dhe vrasje. Shumë shpesh ne bejmë gabim kur stigmatizojmë narkomanët ku ata edhe më tepër mbyllen në botëne tyre të pa shpresë e ne më këtë veprim ata i qojmë kah gremina jetësore e izolimit dhe bojkotimit social e profesional. Narkomanëve u duhet mbështetje morale e materiale për një risocializim sa më human, qendrim ky i cili do të rriste numrin e atyre që do të hiqnin dorë nga ky aktivitet ogurzezë keqëberës.



DOM ELLER VI ?

Vi ser dom då ofta när dom drar förbi i den ruta, som visar vår värld.
En luggsliten skara, i paltiga kläder, som begynt sin mångmilafärd.
De lämnade sitt hem, sin by och sitt land. Dom vädjar Om hjälp från främmande hand.

Visst ville dom stanna där sina rötter dom har.
Men nu Blott minnet av hemmet finns kvar.
För på Kosovos natthimmel ljussken förnimmes.
Det Är byar som brinner. Hem som försvinner.
Allt, som var deras nu är aska och sand.
Det kunde ha varit vårt land.

Två åldringar kämpar, är envis och trägen. Men stegen är korta och lång är vägen.
För att rädda sina liv , dom nu är på flykt,
undan kulor,hat och förtryck.
Allt, som var deras är bränt och förött, nu är dom
Gamla och känner sig trött.
Vid kanten av vägen, dom sätter sig ner.
Kraften är borta, dom orkar ej mer.
Sina ögon dom sluter, dom öppnas ej mer. Oron är borta, kulorna med.
Sitt liv fick dom sluta i förnedring förstådd.
De kunde

Ha varit någon av oss.
Hon går där så böjd i landsvägen grus.
En kuvad
gestalt utan hem eller hus.
Hennes make är mördad, finns inte mer.

Natten är
mörker, framtiden med.
Barnen hon sänt i en annan transport.
Själv följer hon skaran som ringlar sig bort.
Bort från sitt hem och sitt älskade land.
Ensam hon är utan stödjande hand.
Var finns du min Gud, när sådant sker?

En fråga hon delar med många fler.
Så blev deras livslott att flyktingar vara.
Vi kunde ha varit i samma skara.

Men låt oss ändå få hoppas, låt oss ändå få tro
Att även så en flykting kan finna sig ett bo
En plats, ett hem där fruktan förbyttes i framtidstro
Där inget gammalt hat givs tillfälle att få gro
För inget kulor, bomber och ruiners grus
Kan tillförsikt och kärlek bygga nya hus.

Från boken:

Tankar bakom motorsågen

Autor:

Karl Nordström



Ata apo ne ?

Ne shpesh i shohim ata atëherë kur tërhiqen
përbri në atë drejtkëndësh,
që e tregon botën tonë.

Një grup i rraskapitur, me rroba të grisura,
që kanë nisur udhëtimin –
e tyre prej shumë miljesh.

Ata e braktisën shtëpinë e tyre, fshatin e
tyre dhe atdheun e tyre.
Ata luten për ndihmë nga dora e huaj.

Donin sigurisht atje të rrinin ku të drejtat e
tyre i kishin.
Por tash ka mbetur vetëm kujtimi për
shtëpinë.

Sepse natën mbi qiellin e Kosovës vërehet
dritë shkëlqyese.
Janë fshatrat që po digjen.
Shtëpitë që po zhduken.
Gjithçka, që e tyre ishte tash është bërë hi e
dhe.
Do të mund të ishte i yni atdhe.

Dy pleq mundohen, janë të palëkundur dhe
këmbëngulës. Por hapat të vegjël janë e
udha është e gjatë.
Për ta shpëtuar jetën, ata tani janë në ikje,
matanë plumbave, urretjes dhe shtypjes.
Gjithçka, që ishte e tyre është djegur dhe
shkatërruar, ata janë tash pleq dhe të
lodhur.
Përskaaj rrugës, ata ulen.
Fuqia i humbet, më nuk munden.
I mbyllin sytë, që nuk hapen më.
Shqetësimi zhduket plumbat bashkë me të.
Në poshtërim kuptohet jetën e përfunduan.

Do të mund të ishte dikush prej nesh.
Ajo ec atje aq e përkulur nëpër rrugën e
fshatit të shtruar me zhavor.

Një form revolte pa shtëpi apo çati.
Burrin ja vranë, s' e ka më.
E errët është Nata bashkë me ardhmërinë.
Fëmijët i ka dërguar me tjetër transport.
Vetë shkon pas grupit që larg dredhohet.
Larg shtëpisë dhe të dashurit vend.
Vetëm ajo është pa dorë mbështetëse.
Ku je ti o zoti im, kur këto gjëra ndodhin?
Një pyetje që e ndan ajo me shumë të tjerë.

Jeta e tyre kishte këtë fat që të jenë
refugjat.
Ne mund të ishim në të njëjtin grup.
Por na lejoni të shpresojmë megjithatë,
Na lejoni të përmallohemi prapëseprapë
Që bile edhe kështu një refugjat
strehimin e vetë ta gjej
Një vend, një shtëpi ku frikën rehatia e
ardhmërisë e zëvendëson

Aty ku s' kan rast urretjet e vjetra të
mbijnë
Pasi asnjë plumb, bombë dhe zhavor
gërmadhash
Të mundet shpresa dhe dashuria të ndërtoj
shtëpitë e reja.

Marrë nga libri: "Tankar bakom motorsågen"
(Mendimet pas sharrës motorike).

Autor: Karl Nordström

Përktheu: Agron Çela



Dhënja e Ndihmës së Parë - Shpëton Jetën

Dhënja e ndihmës së parë është e vjetër sa edhe vetë lloji i njerësimit. Ndihma e parë fillon qysh nga bashkësitë primitive njerëzore. Nëse një anëtar i asaj bashkësie është sëmurë apo lënduar, të tjerët i ofrojnë ujë për ta freskuar ose e dërgojnë në strehimoren e tyre për t'ia ndalur gjakderdhjen në formë ("Kompresioni")ose lidhjeshe. Në kohën e Ilirëve rreth 400 vjet p.e.s kanë përdorurë barna dhe mjete për të sëmurët dhe të lënduarit. Kështu për thyerjen e gjymtyrëve kanë përdorurë shkopinj dhe dërrasa. Në këtë kohë shquhet princesha Ilirë Arnisa, e cila në principatën e saj themelon shkollën e trajnimit të dhënjës së ndihmës së parë. Në veqanti kanë qenë të trajnuara femrat për të iu dhënë ndihmë ushtarëve në luftë kundër helenëve e romakëve për plagët e shkaktuara nga heshtat, shpatat, shigjetat dhe mjetet tjera të kohës. Të lënduarit i vendosnin në strehimore ku iu ofronte ndihma dhe aftësoheshin për të vazhduar luftën. Në kohën e heroit kombëtar legjendar Skënderbeut, ushtarët ishin trajnuar që ti ofrojnë ndihmën e parë njëri-tjetrit. Gjithashtu kanë qenë të edukuara femrat të ofrojnë ndihmën e parë dhe përkujdesjen e më tejme të luftëtarëve duke i aftësuar për të vazhduar luftën çlirimtare kundër imperisë Osmane. Të sëmurët dhe të lënduarit i vendosnin në kalat e Shkodrës, Krujës, Ulqinit etj. Në betejën e Kosovës më 1389, betejë që ka qenë me shumë lëndime, plagosje, gjakëderdhje të mëdha, një ndër marrje pionere dhe heroike në dhënjën e ndihmës së parë, përkujdesjen dhe aftësimin e ushtarëve të lënduar e bëjnë vajzat e Kosovës. Ndihma e parë ofrohet në dy forma:

1. Vetë-ndihma, kur personi i sëmur apo i lënduar i ofron ndihmë vetë-vetës. 2. Ndihma reciproke, kur ndihmën e ofrojnë njerëz të tjerë. Ndihma e parë ofrohet në çdo vend dhe hapësirë, me mjete rrethana. Gjatë dhënjës së ndihmës së parë duhet shikuar a janë të kalueshme rrugët e frymëmarrjes, a ka frymëmarrje, punën e zemrës (pulsin, qarkullimin e gjakut) dhe a ka vetëdije i lënduari apo i sëmuari. Frymëmarrja artificiale është e indikuar dhe bëhet vetëm pas rivendosjes së kalueshmërisë të rrugëve të frymëmarrjes (kur nuk ka sekret, gjak të koguluar, trupa të huaj etj.). Janë katër metoda të frymëmarrjes artificiale:

a) Frymëmarrja "gojë-gojë, përdoret me shekuj: Shpëtimtari bien në gjunjë, me dorën e djathtë e shtynë kokën dhe lakon mbrapa, ndërsa dora e majtë vëhet mbi ball, ashtu që me gishtin e madh dhe

gishtin tregues të dorës së majtë mbyllet vrimat e hundës, kështu që ajri i ekspiruar (i futur në gojë) mos të dal nga hunda, por të shkojë në mushkëri. Ritmi i frymëmarrjes duhet të jetë në çdo pesë sekonda një frymëmarrje, gjegjësisht 12 frymëmarrje në minutë.

b) Frymëmarrja "gojë-hundë" bëhet duke e vurë shpëtimtari gojën e vet në hundën e të lënduarit dhe futur ajrin në mushkëri përmes hundës. Pasi të ketë kontrolluar kalueshmërinë e rrugëve të frymëmarrjes, shpëtimtari bien ë gjunjë në anën e djathtë të kokës së të lënduarit, i cili është i shtrirë në shpinë. Dorën e majtë ia ve në ball duke shtyrë dhe mbajtur kokën nga prapa. Medorën e djathtë ia mban nofullën dhe e ngritë në pozitë të lartë, kështu që të dy nofullat janë të shtënguara dhe me gishtin e madh të dorës së djathtë e mban gojën e mbyllur që ajri i fryrë në hundë mos të dal nga goja. Shpëtimtari merr frymë thellë, e puthit gojën e vet me hundën e të lënduarit me forcë e ekspiron (e qetë ajrin) në rrugët e frymëmarrjes së të lënduarit, madje largohet që elasticiteti i krahërorit ta qesë jashtë ajrin. Ritmi i ekspirimit të ajrit duhet të jetë 10 - 16 herë në minutë. Për metodën e tretë "frymëmarrje me tubues reanimus" dhe metodën e katërt, frymëmarrje me "ambubalon reanimus" nuk do të bëhet fjalë, pasi që nevojiten mjete. Te disa shpëtimtar paraqitet gërditja, kanë mundime, mund edhe të vjellin, për këtë duhet mbuluar gojën dhe hundën me gazë, faculetë apo shami. Tek fëmijët e vegjël, për shkak të fytyrës së vogël, gojës dhe vrimave të vogla të hundës kjo metodë e frymëmarrjes artificiale zbatohet ashtu që shpëtimtari gojën e vet e ve në gojën dhe hundën e fëmijës. Ndihmën e parë është i obliguar ta ofroj çdo qytetarë me mundësit e veta. Nëse kanëoset rreziku, të lënduarit duhet sa ma parë të lajmërojnë ambulancën tel 112. Pasi jeta e njeriut është gjëja më e shtrenjë, shpëtimi i jetës është gjëja më sublime, më madhore që me asgjë nuk mund të krahasohet.

Dr. Med. Ramadan Myrtaj

Spec. Internist-gastroenterohepatolog dhe kardiolog

Vijon





BUREK ME SPINAQ

Për 4 vetë

Nevojiten:

- miell 3 gota uji
- ujë 300 gram
- spinaq 1 kg
- vezë 1 kokërr
- djathë 100 gram
- vaj 1/2 filxhan caji
- kripë, piper

Gatimi:

Hidhet mielli në tepsi dhe hapet një gropë në mes, shtohet ujë me pak kripë. Për 1 kg miell merret 600 gram ujë, megjthëse kjo varet nga lagështia e miellit. Duke e përzier nga mesi, zihet një brumë i fortë i cili punohet për 10 minuta, ndahet në kuleçë, mbulohet me picetë të lagur dhe lihen për 20-30 minuta që të fitojë elasticitet. Nga çdo kulaç bëhen petë të vogla, secila prej tyre spërkatet me niseshte dhe vendosen 3-4 copë mbi njëra tjetrën, pastaj hapen petët e zakonshme. Spinaqi për mbushje pastrohet, lahet dhe përvëlohet për 2-3 minuta në ujë të vluar e kripë, kullohet duke e shtrydhur, pritët dhe përzihet me djathë të thërmuar e vezë, shtohet kripë, piper dhe shtrohet në petë. Në tepsi të lyer me vaj shtrohet gjysma tjetër e petëve, duke i spërkatur secilën me vaj, mbi to shtohet mbushja e përgatitur dhe mbulohet me pjesën tjetër të petëve të spërkatura me vaj. Anët mbështillen nga brenda. Byreku spërkatet me vaj dhe piqet.

ËMBËLSIRË RRUSHI

Nevojiten:

500 gr. miell, pak tharm buke, 200 ml. qumësht i vakët, 100 gr. sheqer, 1 lugë çaji krypë, 1 kg. rrush i zi (më së miri pa fara), 6 lugë ushqimi vaj, miell për përpunim.

Mielli hidhet në një enë të thellë, në mes shtypim një gropë. Tharmin e tretim në qumësht dhe bashkë me gjysmën e sheqerit dhe me krypën i hedhim në miell. Brumin të mbuluar e lëmë 15 minuta në një vend të ngrohtë të vijë. Me tela brumi (të mikserit dore) e përpunojmë në një brum ngjitës, edhe

20 minuta e lëmë të vijë. Pastaj e ngjeshim edhe pak dhe e lëmë edhe 20-25 minuta të vijë. Furrën e ngrohim në 180 gradë. Tepsinë e mbulojmë me letër pjekjeje. Brumin e ngjeshim njëherë dhe e shtrijmë në tepsi ashtu që rrethi i tij në çdo anë të tepsisë të kalojë nga 20 cm. 3/4 e rrushit i vendosim mbi brum dhe gjysmën e sheqerit të mbetur ia shpërndajmë përmbi. Gjysmës e vajit ia spërkatim përsipër. Rrathët e brumit i palojmë nga brenda, rrushin e mbetur ia shpërndajmë përsipër. Sheqerin dhe vajin e mbetur ia hedhim përsipër. Në furrë e pjekim rreth 20 minuta në 180 gradë pastaj e zbresim temperaturën në 150 gradë për 15-20 minuta.

TORTË E SHPEJTË PËR DITË TË NXEHTA -

Nevojiten:

1 litër qumësht, 6 pudinga nga vanilla, 1 gotë uji sheqer, 200 gr kokos, 300 gr arra të bluara, 200 gr keks të bluar, 200 gr sheqer pluhur, 2 margarina, 3 shllaga vanille

Një litër qumësht vëhet për të vluar me 200 gr sheqer, para se ta vejim qumështin për të vluar e hejtim një gotë për t'i përzier 6 pudinga, zihet 2-3 minuta. E lamë pudingun derisa të ftohet. Në një enë tjetër i marrim 2 margarina dhe sheqerin pluhur i zbutim me piru e pastaj i përziejmë me mikser. Këto dy masa i bashkojmë dhe prap i përziejmë me mikser. Këtë masë të fituar e ndajmë në tri pjesë.

Pjesa e parë: i qitet 200 gr kokos



Pjesa e dytë: i qitet 300 gr arra

Pjesa e tretë: i qitet 200 gr keksa të bluar

Me këta përbërës mund t'i japim çfarë do forme që dëshirojmë tortës (të rrumbullakët, katrore apo rolatë) Pjesa me keks duhet të jetë e fundit, pjesa me arra në mes, dhe pjesa me kokos në krye




Plotëso fjalëkryqin me emra të qyteteve kosovare



Sa tullat i mungojnë murit?

Plotëso fjalëkryqin me emra të qyteteve suedeze



Ezjilijet:
 Fjalëkryqi nr. 1
 1. Pëjn, 2. Gjilani, 3. Prishtina, 4. Prizreni, 5. Mitrovica,
 6. Gjakova, 7. Ferizaj.
 Fjalëkryqi nr. 2
 1. Göteborg, 2. Luleå, 3. Stockholm, 4. Borås, 5. Malmö,
 6. Luleå, 7. Ynarburg
 Nr. i tullave që mungojnë është: 35.



Të jesh a të mos jesh?

Bëjmë Apel tek komuniteti shqiptar që të merr pjesë në mbledhjen e përgjithshme të QKSH "Migjeni" që mbahet të dielën me datën:

27 Maj 2007 në ora 15:00, në bibliotekën e qytetit në Borås, Vävarsalen.

Ne jemi përafërsisht 300-350 familje shqiptare në Borås dhe rrethinë. Tash për tash gjindemi në atë grupin e komuniteteve të rralla këtu në Borås që është i paorganizuar, ne nuk jemi përfaqësuar për një kohë të gjatë në ndonjë aktivitet. Kërkesat e shumicës prej nesh janë që ta ndryshojmë këtë gjendje në të mirën tonë. Shtrohet pyetja: Si mund ta ndryshojmë gjendjen e tanishme?

Sa më shumë prej nesh që aktivizohen duke e flijuar kohën e lirë e duke i shfrytëzuar njohuritë dhe kontaktet e veta, aq më mirë do ta kemi të gjithë ne. Kështu mund të përfaqësohemi me dinjitet në shoqërinë suedeze duke e zënë vendin e duhur që na takon dhe duke i shfrytëzuar të drejtat tona si komunitet.

Shumica prej jush keni dëgjuar për publicitetin e madh në media që na u bë neve me rastin e formimit të Qendrës Kulturore Shqiptare "Migjeni" dhe publikimit të numrit të parë të revistës mujore "Dituria". Ky është vetëm fillimi modest i punës sonë që mund të përparohet, zgjerohet dhe zhvillohet më tutje me ndihmën e secilit prej jush. Përfaqësues dhe organizata të ndryshme këtu në Borås dhe më gjërë kanë shprehur dëshirën dhe vullnetin e tyre që të na ndihmojnë. Përfaqësues të shoqatave shqiptare nëpër botë kanë shprehur dëshirën dhe vullnetin e tyre që të bashkëpunojnë me ne.

Është pyetja: Të jemi apo mos të jemi? Sa jemi ne dhe sa mund të angazhohemi në realitet në formë të organizuar? Sa më shumë që jemi aq më të tepër do të fitojmë.

Ne besojmë që tashmë janë pjekur kushtet dhe kemi njerëz të mjaftueshëm për organizim në të gjitha sferat kulturore dhe shoqërore.

Puna jonë do të jetë ideale – që do të thotë joprofitabile për individin por ku ne të gjithë si komunitet do të fitojmë duke e pasuruar jetën tonë kulturore-shoqërore.

Me nderime: Kryesia e QKSH "MIGJENI" në Borås